



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 44 të Rregullores së Kuvendit, në seancën plenare, të mbajtur më 14 shkurt 2017, pas debatit të zhvilluar në lidhje me Forcat e Sigurisë së Kosovës, me propozim të GP të AAK-së dhe me harmonizim nga GP i PDK-së, LDK-së, Lëvizjes “Vetëvendosje”, “Nisma” dhe “6+”, nxjerr këtë:

REZOLUTË

1. Qeveria e Kosovës autorizohet që sa më parë ta koordinojë dhe ta procedojë në Kuvend për miratim Strategjinë për transformimin e Forcës së Sigurisë në Forcë të Armatosur të Kosovës,
2. Duke shprehur solemnisht përkushtimin e paalternativë për integrim në Organizatën e Paktit Veriatlantik (NATO), Kuvendi i Kosovës, Qeveria e Kosovës dhe mekanizmat tjerë institucionalë t’i bashkërendojnë angazhimet për harmonizimin e përpjekjeve të përbashkëta me NATO-n dhe SHBA-në për zhvillimin e kapaciteteve operationale konform mandatit të ri të Forcave të Armatosura të Kosovës.

Nr. 05-R-010

Prishtinë, më 14 shkurt 2017

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Kopja e Rezolutës u dërgohet:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Arkivit të Kuvendit.